

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
« "ENO 06" » shpk

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar « "ENO 06 « shpk, eshte krijuar sipas Aktit te Themelimit qe i bashkelidhet ky Statut, ne perputhje me legjislacioni shqiptar ne fuqi , Kodin Civil ne fuqi , ne mbeshtetje te Ligjit nr. 990 1 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregetare", ligjit nr. 9723 date 03.05. 2007 «Per Qendren Kombetare te regjistrimit « ate Doganor, Fiskal,Tatimor ,i perpiluar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem i kesaj shoqerie Menelaos Arben Semanjaku datelindje 06.06.1995 per sa me poshte vijon :

Neni 1

Emertimi i Shoqerise

Shoqeria « ENO 06 » shpk eshte e llojit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar .

Neni 2

Kohezgjatja e Veprimitarise

Shoqeria « ENO 06 » shpk do te veproje per nje periudhe kohore pa afat te caktuar .

Neni 3

Emertimi dhe Qendra { Selia }

Shoqeria « ENO 06 » shpk do te kete qendren (seline) e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise ne Adresen: Fshati Sheqishte , z. Kadastrale 3361, nr. Pasurise 30/69-NI Godine Ekonomike Njesia Administrative Zharrez, Bashkia Patos.

Neni 4

Objekti i Veprimitarise

Objekti i veprimitarise se shoqerise do te jete :

Prodhim,magazinim dhe perpunim I produkteve bujqesore,blektorale,industriale ,tregtimi I tyre brenda dhe jashte vendit. Importimi dhe eksportimi I tyre dh te tjera si lenda e pare per to,makineri e paisje te ndryshme,perdorimi I tokes bujqesore ngritja e objekteve te nevojshme per te gjithë veprimitarin e mesiperme.Prodhim ,perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez.Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore per njerez. Tregtim me pakice e shumice I kafsheve te gjalla si dhe mbareshtimi I tyre.Transport nderkombetar per vete per te trete dhe me qera.

Neni 5

Shoqeria « ENO 06 » shpk mund te hape filiale te saj ne te gjitha rrethet e vendit ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi

II . Kapitali Themeltar , Kontributi , pjeset e Kapitalit themeltar .

Neni 6

Kapitali baze i Shoqerise eshte

6/ 1 a- Ne Lek — 100.000,00 (nje qinde mijë) lek, i ndare dhe formuar ne 1 kuote (pjesë). Vlera nominale e kuotes te kapitalit eshte 100.000,00 (nje qinde mije) leke . Ortaku themelues i shoqerise zoteron perkatesisht :

- Ortaku **MENELAOS SEMANJAKU** zoteron 1 kuote ose 100 % te kapitalit te shoqerise me vlere kontributi ne para 100.000,00 (nje qinde mije) leke

- Kapitali i Shoqerise do te ngurtesohet ne Bank pasi kjo Shoqeri te regjistrohet ne QKB

6/2 Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike ,financiare si dhe te vendimeve qe do te marrim ne ortaket per ta rritur ate ne te ardhmen.

6/3 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie , ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve e pasardhesve

sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

6/4 Pjeset e kapitalit themeltar ortakut mund t'ua transferojne te treteve vetem me miratimin e plote te tij.

6/5 Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar gjithmone duhet bere me akt noterial.

6/6 Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakut te vetem të shoqërisë

Ky fitim do të disponohet lirisht prej tij , ne baze te raportit te kontributit te tij ne kapitalin themeltar, pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve dhe te jene hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1\ 10 te kapitalit te shoqerise .

III Organet drejtuese te shoqerise , Marrja e vendimeve, Administrimi, kompetenca dhe kontrolli i Shoqerise .

Neni 7

Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është Asambleja e Ortakeve

7/ 1 Shoqeria do te administrohet dhe drejtohet per nje periudhe 5 (Pëse} vjeçare me te drejte rizgjedhjeje, nga Administratori i shoqerise Menelaos Semanjaku , I biri i Arben lindur me dt 06.06.1995 ne Fier me numer personal J50606029K ,i cili do te jete drejtues ligjor i saj, si dhe do te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet.

Administratori e përfaqëson juridikisht atë në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë , ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e Administrimit ne interes te shoqerise. Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e ortakut te kesaj shoqerie. Emerimi i tij behet per 5 vjet financiar. Me mirekuptimin e ortakut ai mund te qendroje si i tille edhe pertej ketij afati me kusht shqyrtimin formal te kandidatures se tij menjehere pas mbarimit te mandatit

5 vjecar. Administratori e pushon veprimtarine e tij kur jep doreheqjen

Perfundon afati, Shkel rende e ne menyre te perseritur statutin, aktin e themelimit dhe ligjet e shtetit shqiptar .

Neni 8

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit ndaj shoqerise apo te treteve ,per shkelje te ligjeve, te dispozitave te ketij statuti ,apo per faje gjate administrimit te shoqerise .

Neni 9

Disa nga kompetencat qe i jepen Administratorit jane:

1- Te siguroje drejtimin e mire te shoqerise ,te administroje pasurine e shoqerine, te perfaqesoje shoqerine ne maredhenie me te tretet ,te perfaqesoje shoqerine perpara organeve gjyqesore ose autorizon persona te tjere kompetente.

2- Kryen veprime juridike ne emer dhe per llogari te shoqerise me te tretet si lidh kontrata , ben çelje te kredive, kryen veprime te ndryshme bankare, etj.

3- Administratori ka te drejte te marre pjese ne shitblerje, proçedura falimentimi, te tjetersoje pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, te hap llogari rrjedhese prane bankave shqiptare dhe te huaja.

I pajisur me Prokure te Posaçme nga Asambleja, administratori mund te kaperceje dhe te veproje edhe pertej kompetencave te siperpermendura ne kete nen.

4- Adminstratori merr persiper te gjitha vendimet qe jane ne interes te punes dhe prodhimit per problemet e emergjences, raporton dhe pergjigjet para asamblese per drejtimin e shoqerine, vendos per marrjen ne pune dhe largimin apo pushimn nga puna te personave qe ai ka ne varesi administrative.

Neni 10

ASAMBLEJA

Te drejtat dhe detyrimet

- 1) Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
 - a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
 - b) Ndryshimin e statutit.
 - c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
 - ç) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
 - d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne piken c dhe ç te kesaj pike
 - dh) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise,
 - e) Miratimin e pasqyrave finaciare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise ,
 - f) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
 - g) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
 - gj) Perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne proçedimet e tjera ndaj administratoreve
 - h} Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
 - i) Miratimin e rregullave proçeduriale te mbledhjeve te asamblese
 - j) Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji
- 2) Asambleja e pergjithshme merr vendime per ceshtjet e percakturara nga shkronjat « e• dhe • f» te pikes 1 te ketij neni pas marrjes ne shqyrtim te dokumentave perkatese .
- 3) Te gjitha vendimet e marra regjistrohen ne nje regjister te vendimeve te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen . Duhet regjistruar ne veçanti por pa u kufizuar ne to , vendimet per :
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
 - b) shpernadrjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
 - c) investime
 - ç) vendime per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

Neni 11

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

- 1- Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne Mbledhjen e zakonshme qe therritet te pakten nje here ne vit dhe sa here qe mbledhja eshte e nvojshme per te mbrojtuar interesat e shoqerise.
- 2- Asambleja e pergjithshme therritet nga administrator
- 3-Asambleja e pergjithshme therritet nese , sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjeteme finaciare , rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 3- Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 perqind te aseteve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit finaciare te çertifikuara.
- 5- Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria , brenda dy viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri , qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit finaciare te çertifikuara .
- 6- Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 e 5 te ketij neni asamblese se pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar , i pavaruar.

Neni 12

Menyra e thirrjes

1- Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftimim nepermjete postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten,oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

2- Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme nese te gjithë ortakët jane dakorte per te marre vendime , panvaresisht rregullise .

Neni 13

Perfaqesimi ne Asamble

- 1- Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje person i trete
- 2- Administratori nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne Asamblen e pergjithshme
- 3- Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te pergjithshme e cila perfshin dhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 14

Kuorumi

- 1- Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave . Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per ceshtje te cilet kerkojne shumice te kualifikuar sipas Nenit 15 ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo me mjete elektronike
- 2- Nese asambleja e pergjithshme nuk mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur ne piken 1 te ketij neni , Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite.

Neni 15

Marrja e vendimeve

- 1- Asambleja e Pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarrres per ndryshimin e statutit , zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar , shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- 2- Per ceshtjet e tjera te renditura ne Nenin 11 Asambleja e Pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrres .

Neni 16

E drejta e votes

- 1- Çdo kuote jep te drejten e nje vote.
- 2- Ortaket qe nuk jane te pranishem kane mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

Neni 17

Perjashtimi nga e drejta e votes.

- 1- Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese Asambleja e Pergjith shme merr vendim per:
 - a) vleresimin e veprimtarise setij.
 - b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
 - c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria.
 - ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
- 2- Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar , i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi ashtu si dhe ortaku , te cilin perfaqeson.

Neni 18

Proçesverbalet e mbledhjes se Asambles

- 1- Te gjitha vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te regjistrohen ne proçesverbal. Administratori pergjigjet per ruajtjen e kopjeve te proçes verbaleve te mbledhjes se asamblese se pergjithshme.



- 2 - Proçesverballi duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes , rendin e dites , emrin e kryetarit e te mbajtesist te proçesverballit, rezultatet e votimit.
- 3 Proçesverballit i bashkangjitet dhe lista e pjesemarrësve si dhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme .
- 4-Proces verbali i mbledhjes nenshkruhet nga Kryetari dhe nga mbajtesi i procesverballit.

Neni 19

Librat e Shoqerise

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere dhe keto libra :

- 1- Libri i ortakut ne te cilin shenohen emri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar .
- 2- Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te organit vendimor.
- 3- Libri i Mbledhjeve dhe vendimeve te organit administrativ .

IV Viti Financiar dhe llogarite vjetore

Neni 20

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti . Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik

Neni 21

Llogaritë vjetore, inventari, raport et mbi operacionet e vitit financiar dhe çdo raport tjetër i veçantë në këtë drejtim, te hartuara nga Administratori ,nga eksperti kontabel pas shqyrtimit i paraqiten për miratim ortakeve të shoqërisë brenda tre muajve dhe në çdo rast, jo me vonë se tre muaj nga data e mbylljes së vitit. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes .

Neni 22

22/ 1 Veprimtaria ekonomike — financiare dhe tregtare e shoqerise realizohet dhe garantohej ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

22/ 2 Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregtar dhe juridik me persona te trete shoqeria pergjigjet me pasurite e veta.

22/ 3 Aktivi dhe pasivi i veprimtarise se Shoqerise pasqyrohet ne planet ekonomike financiare dhe tregtare te saj te shprehura ne para shqiptare ose te konvertuara ne valute te huaj

22/ 4 Pasurite e shoqerise vleresohen nepermjet bilanceve ekonomiko- financiare dhe tregtare te saj ,ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi .

22/ 5 Te ardhurat e shoqerise pasi te zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurise se palujteshme dhe te luajteshme si dhe shpenzimet e tjera qe behen ne interes te shoqerise , i takojne ortakeve te shoqerise sipas dispozitave te percaktuara ne aktin e Themelimit dhe ne Statutin e krijimit te saj.

22/ 6 Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise ajo i mbulon nga fondi reserve ose nga shumat suplementare. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit te investuar ne te.

22/ 7 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi.

22/ 8 Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Administratori i shoqerise .

Neni 23

Mjetet e investuara për themelimin e shoqërisë si dhe ato të shtuara nga aktiviteti i saj i zgjeruar regjistrohen në librin afarist të shoqëri së menjëherë. Shoqëria ësh të pronare, përdoruese, disponuese e pasurive në emër të vet në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj.

V . Dividentet

Neni 24

Pas mbarimit te llogarive vjetore dhe te evidentimit te ekzistences se fitimit , percaktohet pjesa qe iu takon ortakeve themelues ne formen e dividendit mbi fitimin . Ky fitim perbehet nga : fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin e lene rezerve te domosdoshem te percaktuar nga ortaket , te fondeve te tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjetere jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme .

Neni 25

Pasuritë e shoqërisë vlerësohen me bilancet e saj, me vlera të shprehura në monedhë shqiptare dhe të huaj, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse të zbatuara në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me të huaj dhe e kundërta bëhet në përputhje me kursin e caktuar nga Banka në momentin e këmbimit të saj.

VI. Punesimet ne shoqeri

Neni 26

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës, e cila mund të jetë kolektive dhe individuale. Çështjet të cilat nuk gjejnë rregullim në kontratat e punës zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar: Kodi i Punës dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që ka të bëjë me këtë çështje.

Neni 27

I punësuarit nuk merr pjesë në ndarjen e fitimit të cilin e realizon shoqëria gjatë veprimtarisë së saj apo edhe në humbjet e saj , nëse në kontratën e punës nuk është përcaktuar ndryshe.

Ai përgjigjet materialisht për dëmet që i shkakton shoqërisë me faj.

VII . Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë .

Neni 28

Shoqëria priset para kohe kur:

Aktiviteti ekonomik i saj per disa vjet radhazi eshte ne humbje.

Per arsye te parashikuara ne ligj,

Veprimi i kushteve te forcave madhore,

Dalja e nje vendimi nga Organet Kompetente qe ndalon veprimtarine e saj Shoqëria hyn në procesin e likuidimit të saj qysh në momentin e prishjes ose të shpërbërjes.

Per kryerjen e ketij procesi ortaket caktojne nje ose disa likujdues te cilet i paraqesin asamblese raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatet e nevojshme te perfundimit te tyre . Ne fund te procesit te likuidimit ortaket vendosin mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit .

Pas pagimit te kreditoreve dhe te shlyerjes, kapitali themeltar kontribues dhe gjithe kapitali financiar e material i mbetuar ndahet ne pjese te barabarta ndermjete ortakeve.

VIII. Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Neni 29

Zgjidhja e mosmarreveshjeve qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise do te zgjidhen me mirekuptim e nese kjo nuk arrihet atehere pala e interesuar mund ti drejtohet organeve kompetente te juridiksionit te vendit ku kane lindur mosmarreveshjet.

IX. Dispozita te pergjithshme

Neni 30

Ne rast se ne Republiken e Shqiperise shpallen ligje ,dekrete, ose vendoset nje politike me e favorshme nga legjislacioni i pasqyruar ne Aktin dhe Statutin e krijimit te Shoqerise atehere ne ortaket e kesaj shoqerie kemi te drejten ti drejtohem organeve perkatese shteterore qe te zbatojne legjislacionin me te favorshem per shoqerine e krijuar.

X . Dispozita te veçanta

Neni 31

31/ 1 Te gjitha dokumentat e shoqerise do te permbajne adresen e plote te saj , numrin e regjistrimit ne Rregjistrin Tregetar te QKB , Numrin Unik te Identifikimit per ushtrimin e veprimtarine e saj.

31/ 2 Per çeshtje te tilla qe nuk parashikohen ne Statut , veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne legjislacionin perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

Neni 31

Ky Statut i perpiluar nga Ortaku i saj ne kater kopje te barabarta , hyn ne fuqi qysh ne momentin e nenshkrimimit nga ana jone dhe shoqeria do te behet aktive mbas regjistrimit ne QKB veprime te cilat do ti kryeje Administratori i Shoqerise MENELAOS SEMANJAKU. Ne rastet e likujdimit perfundimtar te shoqerise , sipas legjislacionit ne fuqi , pushon se vepruari edhe ky Statut i saj. Krahas persosjes se metejshme te legjislacionit tregetar si dhe te ecurise se veprimtarise se shoqerise, ortaku ka te drejten e permiresimit te metejshem dhe te dispozitave te ketij Statuti, dhe te te gjitha dokumentave te Shoqerise duke bere depozitimet perkatese sipas legjilacionit ne fuqi .

Statuti i mesiperm u nenshkrua nga Une ortaku i shoqerise sot me date 07/11/2023 .

ORTAKU I SHOQERISE

Menelaos Semanjaku

